



## NDRYSHIME NE STATUTIN E SHOQERISE "WISDOM" SHPK

Sot me date 30.11.2012, ne seline e shoqerise "Wisdom" shpk, Asambleja e Pwrgjithshme e ortakeve te Shoqerise "Wisdom" sh.p.k e perbere nga ortaket , Marius Kapxhiu dhe Arlind Kapxhiu perfaqsoar me prokure nga Ilir Kapxhiu, hartojne dhe miratojne keto ndryshime ne statutin e shoqerise "Wisdom" sh.p.k, bazuar ne nenin 230 pika 2 te ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ne pershtatje me kerkesat e ketij ligji. Ne statut behen ndryshimet dhe pershtatjet si me poshte:

### **Themelimi i shoqerise**

Shoqeria tregtare "Wisdom" shpk, eshte themeluar ne vitin 1996 nga ortaku i vetem Ilir Kapxhiu, me emrin fillestar te shoqerise e quajtur Arlind shpk, e percaktuar sipas vendimit gjyqsor nr 14905 te gjykate tirane.

### **Ndryshimet organizative**

Me vendimin gjyqsor nr14905/1 date 03.09.1996 miratohet shitja e 50% te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise nga kapitali 100% ne pronesi te Ilir Kapxhiut tek Brunilda Paskali. Pas kesaj shoqeria u be me dy ortak Ilir Kapxhiu dhe Brunilda Paskali dhe emri i shoqerise me pas ne vitin 2002 behet wisdom shpk. Kuotat e ortakut Ilir Kapxhiu i jane dhuruar prej tij Arlind Kapxhiu 25% te koutave dhe Marius Kapxhiu nga 25% te kuotave . Shoqeria "Wisdom" sh.p.k ka tre ortake me kuota Arlind Kapxhiu 25 % te kuotave, Marius Kapxhiu 25 % te kuotave dhe Brunilda Paskali 50 % te kuotave. Secili nga ortaket gezon te drejten per tu zgjedhur administrator, pavaresisht nga kuotat qe zoteron.

### **Objekti i veprimtarise**

Objekti i veprimtarise se shoqerise "Wisdom" shpk eshte:

- Hapje e shkolles tetevjecare, shkolles se mesme dhe universiteti.
- Hapje e ciklit parashkollor, kopesht, kurse kualifikimi ne gjuhe te huaja , hapje e shkolles se mesme te pergjithshme te gjuheve te huaja, hapja e kurseve per mesim kompjuteri, studime univrsitare, pasuniversitare per master e doktorate per studentet.
- Shoqeria tregtare mund te ushtroj çdo veprimtari e cila nuk ndalohet me ligj.

### **Selia e shoqerise**

Selia e shoqerise do te jete ne qytetin e Tiranes ne adresen rruga "Myslym Shyri", kulla 9, seksioni 3, zyra nr.8, kati i pare, me te drejte per ta ushtruar aktivitetin e saj ne te gjithë teritorin Republikes se Shqiperise. Shoqeria vazhdon aktivitetin veprues ne filialet e saja ne qytetet Elbasan dhe Durrës, Lushnje filale te cilet kane te njejtin personalitet juridik me shoqerine.

### **Administratori**

Administratori i shoqerise z. Ilir Curri, emerohet per nje periudhe 5 vjeçare ne kete detyre duke filluar nga adata 30.11.2012.



Administratori ka te drejten e perfaqesimit te shoqerise me te tretet, si dhe perpara organeve gjyqesore. Administratori ka te drejten te administroje te gjitha llogarite bankare dhe arkat e shoqerise "Wisdom" sh.p.k sipas kerkesave te ligjit.

#### **Organizimi dhe drejtimi i filialeve**

Filialet e shoqerise Wisdom shpk me vendqendrim ne qytetet Elbasan dhe Durres nuk do te organizohen e administrohen me vete por do te jene nen administrimin dhe nen vartesine financiare te shoqerise me « Wisdom » shpk ne Tirane. Keto filiale nga ana organizative do te drejtohen me nivel drejtoresh te emeruar nga administrator i shoqerise me miratimin e ortakeve te shoqerise.

Filialet e shoqerise ushtrojne aktivitetin nen emrin e regjistruar te shoqerise tregtare "Wisdom" shpk

Te gjitha detyrimet tatimore te filialeve te shoqerise te perfituara nga te ardhurat e aktivitetit te tyre ne emer te shoqerise mem do te shlyhen nga ana e arkës financiare te shoqerise meme ne Tirane.

#### **Kohezgjatja e shoqerise**

Kohezgjatja e shoqerise Wisdom shpk pa afat te percaktuar. Afati eshte deri kur shoqeria pushon ushtrimin e veprimtarise apo kur shoqeria eshte e detyruar ta pushoj ate.

Shoqeria mund te ndryshoj emrin,qendren e ushtrimit te aktivitetit si dhe objektin e veprimtarise me vendim te Asamblese se Pergjitheshme

#### **Kapitali i shoqerise**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 12.500.000 (dymbedhete million e peseqindmije) leke. Brunilda Paskali ka 50 % te kuotave ne vlere 6 250 000 (gjashte million e dyqind e pesedhete mije), Arlind Kapxhiu ka 25 % te kuotave ne vlere 3 125 000 (tre million e njeqind e njezete e pese mije) dhe Marius Kapxhiu ka 25 % te kuotave ne vlere 3 125 000 (tre million e njeqind e njezete e pese mije).

#### **ASAMBLEJA E PERGJITHSHME E SHOQERISE " WISDOM" SHPK**


##### **ORTAKET**

**ARLIND KAPXHIU**

**MARIUS KAPXHIU**

**PERFAQESUAR ME PROKURE NGA**

**ILIR KAPXHIU**



**BRUNILDA PASKALI (NE MUNGесе)**

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANE  
U APLIKUA PULLA 200 LEKE

NR REP 2127  
NR KOL 444

**AUTENTIFIKIM NENSHKRIMI**

Sot, me date 30.11.2012 (dymije e dymbedhjete), ne Dhomen e Noterise Tirane, paradite dhe para meje noteres se kesaj dhome te quajtures Alma Burgaj, me seli ne rrugen e Dibres, Tirane, u paraqit personalisht:....

**ILIR KAPXHIU**, i biri i Selim-it, me datëlindje 27.07.1959, lindur në Tirane dhe banues në adresën RRuga Gjergj Fishta pallati E 88, shk.2 ap.18, Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit elektronik me nr. 028957719, në cilësinë e perfaqesuesit me prokure te ortakeve te Shoqerise "Wisdom" sh.p.k z. Marius Kapxhiu dhe z. Arlind Kapxhiu, për identitetin e te cilit u sigurova në bazë të letërnjoftimit elektronik dhe pasi konstatova se i ka te gjitha aftesite e ligjit, me kerkesen e tij i vërtetova nënshkrimin e vëne prej tij para meje noteres te ndryshimve te bera ne "Statutin" nga mbledhja e dates 30.11.2012 te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve te Shoqërisë "Wisdom" Sh.P.K dhe unë noterja e vërtetova sipas ligjit.

**NOTERI**  
**ALMA BURG AJ**